



ZYRA E INSPEKTORIT  
TË LARTË TË DREJTËSISË

Nr. 1006/11 Prot., datë 03/04/2023



UNIVERSITETI I ELBASANIT  
"ALEKSANDËR XHUVANI"

Nr. 917 Prot., datë 03/04/2023

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

DHE

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Prill 2023

Duke vlerësuar bashkëpunimin e ndërsjellë, në përputhje me fushat e përbashkëta të interesit dhe rritjen e transparencës në raport me qëllimin e rritjes së ndërgjegjësimit të publikut.

Në referim të kompetencave dhe përgjegjësiive të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, në Republikën e Shqipërisë”, duke synuar me anë të vullnetit të dyanshëm, forcimin e bashkëpunimit për edukim ligjor,

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**, përfaqësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani

dhe

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**, përfaqësuar nga Rektori i Universitetit Prof. Dr. Skender Topi

më poshtë referuar si “*Palët*”, bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum bashkëpunimi sipas dispozitave sa vijon:

Neni 1

### **Objekti i Memorandumit**

Në përputhje me qëllimin e këtij Memorandumit, palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë për thellimin dhe shkëmbimin e njohurive në fushën e drejtësisë, duke ndërmarrë iniciativa me interes të përbashkëta.

Neni 2

### **Parime të Përgjithshme**

1. Ky memorandum lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të palëve që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Ky memorandum shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk cenojnë apo ndikojnë te të drejtat

dhe detyrimet që u burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.

3. Palët njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin për iniciativa ku përfshihen studentët dhe personeli akademik, ndihmësakademik, që lidhen me realizimin e veprimtarive të përbashkëta, në bashkërendim me ligjin, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të tyre.

### Neni 3

#### **Roli dhe përgjegjësitë e palëve**

1. Të dyja Palët, sipas kushteve, mundësive dhe kapaciteteve të burimeve njerëzore marrin përsipër të kontribuojnë në:
  - a. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e drejtësisë, përfshirë nisma që kanë karakter akademik, hulumtues dhe të shkëmbimit të përvojave të nevojshme;
  - b. Shfrytëzimin e kapaciteteve të përbashkëta për ndërtimin e programeve edukuese, që i shërbejnë komunitetit të studentëve;
  - c. Mundësinë e realizimit të praktikës për studentët e Departamentit të së Drejtës, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
  - d. Organizimin e tryezave dhe ligjëratave që kanë në fokus edukimin ligjor dhe profesional;
2. Përveç sa përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr përsipër të angazhojë studentët e së Drejtës, në punë praktike në kuadër të veprimtarisë së saj, duke mbajtur në konsideratë rregulloret e brendshme të institucionit.
3. Përveç sa përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” merr përsipër, që sipas nevojës, t’i përgjigjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke ofruar ekspertizën e personelit akademik, varësisht nga vlerësimi i përbashkët.

### Neni 4

#### **Format dhe mënyrat e bashkëpunimit**

1. Bashkëpunimi midis Palëve do të realizohet me anë të projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta, shkëmbimit të informacionit dhe botimeve akademike apo periodike, shkëmbimit të personelit dhe studentëve.
2. Kërkesa për informacion, shkëmbim apo zhvillim të veprimtarive të përbashkëta do t’i drejtohet palës tjetër me shkrim dhe në gjuhën shqipe.

3. Kërkesa për bashkëpunim duhet të sigurojë një përshkrim të përgjithshëm lidhur me qëllimin për të cilin kërkohet bashkëpunimi dhe kohën e dëshiruar për konkretizimin e bashkëpunimit.

#### Neni 5

##### **Koordinimi dhe komunikimi mes Palëve**

1. Për të koordinuar veprimtaritë në kuadër të këtij Memorandumi, komunikimi mes Palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore ose përmes postës elektronike, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit
2. Kërkesa për informacion, shkëmbim apo zhvillim të veprimtarive të përbashkëta do t'i drejtohet palës tjetër sipas mënyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Pala së cilës i drejtohet kërkesa për informacion, shkëmbim apo zhvillim të veprimtarive të përbashkëta, pasi e analizon atë, i siguron palës tjetër informacionin që zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, pala së cilës i drejtohet kërkesa duhet t'i japë përgjigjen me shkrim palës tjetër, në lidhje me shkaqet që e pengojnë.
4. Për të realizuar komunikimin palët do të caktojnë nga një ose më shumë anëtarë të stafit të tyre si persona kontakti, me përgjegjësi për mbajtjen e të gjithë komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe përgatitjes së nevojshme për zbatimin e këtij Memorandumi.

Palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

#### Neni 6

##### **Kostot Financiare**

Çdo kosto financiare që rezulton nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohet legjislacionit në fuqi dhe është brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

#### Neni 7

##### **Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja**

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe është i vlefshëm për një periudhë kohe të pacaktuar.



Neni 8

### Ndryshimet e Memorandumit

Ndryshimet e këtij Memorandumi bëhen me shkrim, me miratimin e të dyjave Palëve.

Neni 9

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe përfundimi i Memorandumit

1. Palët zotohen që të zgjidhin çfarëdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi përmes konsultimeve miqësore e në mirëbesim mes tyre.
2. Secila Palë mund të tërhiqet nga ky Memorandum në çdo kohë, përmes njoftimit me shkrim Palës tjetër.

Pasi u lexua, u gjend i rregullt dhe në përputhje me vullnetin e të dyja palëve, Memorandumi i Bashkëpunimit nënshkruhet nga secila palë.

Nënshkruar në Elbasan më 03.04.2023, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike.

**PËR ZYRËN E INSPEKTORIT**

**TË LARTË TË DREJTËSISË**



**ARTUR METANI**

**INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË**



**PËR UNIVERSITETIN E ELBASANIT**

**“ALEKSANDËR XHUVANI”**

**Prof. Dr. SKENDER TOPI**

**REKTOR**

